



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 511/2023
Datë: 09.05.2023

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 (1.4) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9), të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Taulant Kelmendi emërohet Zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministres së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministria, si dhe për zëvendësimin e Ministres kur ajo mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e saj.
3. Zëvendësministri, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Taulant Kelmendi, Zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.